



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 16 datë 21 .01.2019

PËR NDËRPRERJEN E URDHËRIT PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Në Tiranë, sot më datë 21.01.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi dëgjoj, në mbledhjen plenare të datës 21.01.2019, relacionin e Komisionit të Karrierës, si dhe mendimet e paraqitura nga Anëtarët e Këshillit në këtë mbledhje,

K O N S T A T O J

Zoti Olsian Çela i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me njoftim nr.05, datë 27.12.2018, me anë të të cilit, Këshilli bëhet me dije në lidhje me urdhrin nr.198 datë 20.09.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, për caktimin e përkohshëm të z.Olsian Çela, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, të ushtrojë këtë funksion si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.

Në njoftimin e paraqitur në Këshillë, prokurori pretendon se afati maksimal prej tre muaj që ai mund të caktohen përkohësisht në një prokurori, ka përfunduar dhe kërkon që Këshilli të konstatojë këtë fakt dhe të marrë një vendim në lidhje me statusin profesional të tij.

Prokurori i Përgjithshëm e ka bazuar urdhërin në dispozitat kalimtare të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, e pikërisht në nenin 160/4 të këtij ligji.

Sipas nenit 160/4 të Ligjit nr.96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, Prokurori i Përgjithshëm, në kushtet kur nuk është krijuar akoma Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë mund të vendosë caktimin në pozicione të përkohshme të magjistratëve.

Kjo dispozitë është kalimtare dhe e parashikuar nga ligjvënësi për tu zbatuar për një periudhë kohore maksimale deri në 8 muaj, deri në ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe për këtë shkak dispozita e nenit 160/4, nuk ka parashikuar afate dhe rregulla të tjera për caktimin në pozicion të përkohshëm.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, tashmë i krijuar, ka për detyrë ndër të tjera të garantojë pavarësinë, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, në pëputhje me parashikimet kushtetuese si edhe në pëputhje me rregullimet ligjore të parashikuara në pjesën e tretë të Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“ të titulluar “Zhvillimi i karrierës së magjistratëve”. Të gjitha këto rregulla kanë si qëllim zhvillimin e karrierës së prokurorëve sipas eksperiencës dhe meritës duke garantuar pavarësinë e tyre. Sipas dispozitave ligjore të këtij kreu, magjistrati pasi është emeruar dhe caktuar në një pozicion mund të lëvizë nga detyra e tij në këto raste:

- Transferimit të perhershëm nëpërmjet lëvizjes paralele;
- Transferimit të përkohshëm;
- Ngritjes në karrierë;

- Komandimit në institucione të tjera të sistemit të drejtësisë;
- Caktimi sipas skemës së delegimit
- Caktimit të përkohshëm.

Legjislatori është kujdesur për të gjitha rastet e sipërcituara të përcaktojë rregulla shumë strikte dhe të detajuara që **garantojë palëvizshmërinë nga detyra të magjistratit pa pëlqimin e tij**. Rastet kur Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të caktojë një prokuror, në një pozicion pa dëshirën e tij, janë përjashtimore, shteruese dhe kryhen sipas rregullave të mirëpërcaktuara, ose bëhet fjalë për situata urgjente që zgjasin maksimumi deri në tre muaj.

Në Kushtet kur Këshilli i Lartë i Prokurorisë është krijuar dhe dispozitat e përcaktuara nga kreu i III-të i Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” tashmë janë të zbatueshme dhe te detyrueshme për Këshillin, Prokurori z.Olsian Çela, duhet të kthehet të ushtrojë detyrën në pozicionin ku është i emëruar, për sa kohë ai nuk ka dhënë pëlqimin e tij për lëvizjen nga ky pozicion dhe për sa kohë nuk plotësohen rrethanat, kushtet apo kriteret e parashikuara nga neni 42, 46 apo 59 i Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shumicë votash,


V E N D O S I


1. Të ndërpresë Urdhërin nr.198, datë 20.09.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm” të z.Olsian Çela, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe ta rikthejë në pozicionin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë.
2. Të njoftohen me këtë vendim prokurori Olsian Çela, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimeve të Rënda Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETARI
ANËTAR KUNDËR
GENT IBRAHIMI
ANËTAR PRO
ANTONETA SEVDARI


ANËTAR PRO
ARBEN DOLLAPAJ

ZV/KRYETARI
ANËTAR KUNDËR
ALFRED BALLA

ANËTAR KUNDËR
BESNIK CANI


ANËTAR PRO
BUJAR SHESHI


ANËTAR PRO
GENTJAN OSMANI


ANËTAR PRO
KOSTAQ BELURI


ANËTAR KUNDËR
NURIHAN SEITI


ANËTAR PRO
SANDËR BECI


ANËTAR KUNDËR
TARTAR BAZAJ